

VENDIM
Nr.82, datë 10.2.2010

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KROACISË, PËR NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN DYPALËSHE EKONOMIKE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KROACISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për ndryshimet në marrëveshjen dypalëshe ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË MBI NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN
MBI MARRËDHËNIET EKONOMIKE DYPALËSHE NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë (këtu quhen “Palët kontraktuese”),

në lidhje me marrëveshjen mbi marrëdhëniet bilaterale ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, të përfunduar në Zagreb, më 10 maj 1993 (këtu të quajtur “Marrëveshja”),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Neni 2 i Marrëveshjes shfuqizohet.

Neni 2

Neni 8 i Marrëveshjes shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 10 të Marrëveshjes, paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 4

Pas nenit 10 të Marrëveshjes, shtohet neni i ri “10 a”, që lexon si më poshtë:

“Neni 10 a

Që nga data e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian, kjo Marrëveshje zbatohet pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga kjo anëtarësi. Për pasojë, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të citohen ose interpretohen në një mënyrë të tillë që të zhvlerësojnë ose ndryshe të ndikojnë mbi detyrimet e vendosura nga Traktati i Bashkimit Europian dhe Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar në Luksemburg më 12 qershor 2006.

Për më tepër, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të citohen apo interpretohen në një mënyrë të tillë që të zhvlerësojnë ose ndryshe të ndikojnë në detyrimet që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare që do të lidhen, duke zëvendësuar marrëveshjet e mësipërme.”.

Neni 5

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë mbi ndryshimet e Marrëveshjes mbi marrëdhëniet bilaterale ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë hyn në fuqi në datën e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian, në të cilën Republika e Kroacisë, në kohën e duhur, do të informojë Republikën e Shqipërisë, me kusht që në atë datë palët kontraktuese të kenë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Nëse palët kontraktuese nuk njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme në datën e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian, Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë mbi ndryshimet e Marrëveshjes mbi marrëdhëniet bilaterale ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit palët kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Bërë në Zagreb, më 10 shkurt 2009, në dy kopje origjinale, secila në shqip, kroatisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në anglisht mbizotëron.